



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL – SKUPŠTINA OPŠTINE - MUNICIPALITY ASSEMBLY
JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/06

Datë: 22.02.2010

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 52, Statutit të Komunës së Junikut neni 34.1, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e mbajtur me 22.02.2010, mori këtë:

VENDIM

Për Formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Neni 1

Me këtë vendim Komiteti për Politikë dhe financa formohet prej anëtareve nga përbërja e Kuvendit të Komunës, numri dhe struktura e të cilëve caktohet me vendim të Kuvendit. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa janë si në vijim:

1. Sinan Gacaferi- Kryesues, subjekti politik AAK
2. Rasim Maloku-anëtarë, subjekti politik AAK
3. Leonita Jasiqi-anëtare, subjekti politik AAK
4. Visar Shehu-anëtarë, subjekti politik LDK
5. Vllaznim Maloku-anëtarë, subjekti politik LDD

Neni 2

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 52.1, Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 3

Komiteti për politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme , planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm, dhe çdo ndryshim të buxhetit për vitin fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Neni 4

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset, Kryesuesi i Kuvendit dhe Udhëheqësja e personelit në Komunën e Junikut.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa
- Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Sinan Gacaferi
